



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 1 nëntor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti, Petar Miletiq.
Mungoi: Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZPRK, Jusuf Zejna-KDI, Sanije Berisha-OSBE.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 19 tetor 2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 19 tetor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 19 tetor 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare

Albin Kurti- I njoftoi anëtarët e Komisionit, se pas shqyrtimit të Projektligjit dhe miratimit të amendamenteve në cilësi të Komisionit FunkSIONAL, raporti i Komisionit i është përcjellë për shqyrtim komisioneve të përhershme.

Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar nga kompetenca e tyre Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare me amendamentet e propozuara dhe kanë rekomanduar se Projektligji me amendamentet e propozuara, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Pas shqyrtimit të raportit me rekomandime lidhur me Projektligjin për marrëveshje ndërkombëtare, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe i njëjti i procedohet në mbledhje plenare për shqyrtim e miratim.

4. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit u njoftuan me raportin me shkrim të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Budapest, lidhur me Konferencën e Pestë të Kryetarëve të Parlamenteve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

